Rregullat e

Texhwidit

Rregullat e nûn dhe mîm *mushedded*

Mënyra e shqiptimit: Nëse një Mim apo një Nûn është *mushedded* (d.m.th. ka shenjën e *sheddes* përmbi), lexuesi duhet të bëjë *gunneh* (tingull hundor) mbi të për 2 takte.

> Vërejtje: Nëse lexuesi ndalet mbi një fjalë e cila përfundon me Nûn apo me Mim *mushedded*, *gunneh* për Mim apo Nûn ende duhet të zbatohet.

Shembuj:

بِجَهَنَّمَ	بِٱلنَّاصِيَةِ	ٱلنَّاسِ	لَتَرَوُنَّ	أَنَّ
إِنَّآ	فَأُمُّهُۥ	فَأَمَّا	وَأَمَّآ	عَمَّ

El-Kalkaleh

Kalkaleh është hovi apo forca e tingullit në fund të shqiptimit të një shkronje.

Mund të thuhet se kjo është një gjendje mes një *sekin* (shkronjë me shenjën e *sukunit* përmbi) dhe *muteherrik* (shkronjë me zanore apo lëvizje buzësh).

Kalkaleh shqiptohet vetëm atëherë kur shkronja është *sekin* (d.m.th. ose shkronja ka shenjën e *sukunit*, ose i vihet *sukuni* për shkak të ndaljes).

Shkronjat e el-Kalkaleh janë të përmbledhura në shprehjen:

[قطب جد] ose [ق ط ب ج د]


Shembuj:

وَٱلْحَجِّ	أَحَدٌ	صَدْرَكَ
ٱلْحَقُّ	ٱلصَّمَدُ	أَطْعَمَهُم
وَتَبَّ	حَسَدَ	ٱلْأَبْتَرُ



Shkronjat e rënda dhe të lehta

Llojet e shkronjave arabe sipas rëndësisë dhe lehtësisë që ato kanë



Shkronjat e rënda

Këto shkronja janë të përmbledhura në shprehjen:

[خص ضغط قظ] ose [خ ص ض غ ط ق ظ]

Mënyra e shqiptimit e një shkronje të rëndë: Shkronjat e rënda e kanë cilësinë e *istia'le*[1] (ngritjes), sepse, gjatë shqiptimit të tyre, një pjesë e gjuhës (kryesisht pjesa e fundme e saj) ngrihet deri në qiellzë dhe e bën të rëndë shqiptimin e tyre.

Shkronjat e lehta

Këtu bëjnë pjesë të gjitha shkronjat e tjera veç shkronjave të rënda si dhe shkronjave që përkohësisht janë të rënda apo të lehta.

Mënyra e shqiptimit e një shkronje të lehtë: Shkronjat e lehta kanë cilësinë e *istifel*[2] (uljes), sepse, kur të shqiptohen këto shkronja, gjuha ulet.

Elif Med

Cilësia e rëndë apo e lehtë e Elif Med varet nga shkronja para Elif Med. Nëse shkronja para Elif Med është e lehtë, edhe Elif Med duhet të shqiptohet lehtë; nëse shkronja para Elif Med është e rëndë, edhe Elif Med duhet të shqiptohet rëndë.

Gunneh për Ikhfaa Hakiki

Shih faqen 12 për rregullat e Nûn-*sekineh* dhe të *tenwinit*.

Rregullat e Lam-it që gjendet në emrin e lartësuar të Allahut


Kjo ka të bëjë me cilësi të përkohshme.

a) Nëse ka *fet'ha* apo *dammeh* para fjalës 'Allah' apo 'Allahum', atëherë Lam në fjalën 'Allah' do të jetë i rëndë.

Shembull:

---

[1] Për më shumë shih definicionet lidhur me *istia'le* në faqet 30-31.
[2] Për më shumë shih definicionet lidhur me *istifel* në faqet 30-31.



قَالُوٓاْ ٱللَّهُمَّ	سُبۡحَٰنَكَ ٱللَّهُمَّ	يَشَآءَ ٱللَّهُ	وَٱللَّهُ


b) Nëse ka *kesra* para fjalës ‘Allah’, atëherë Lam në fjalën ‘Allah’ apo në ‘Allahum’ do të jetë i lehtë.

Shembull:




قُلِ ٱللَّهُمَّ	دِينِ ٱللَّهِ	لِلَّهِ	بِٱللَّهِ

c) Nëse lexuesi fillon leximin me fjalën ‘Allah’, atëherë Lam në fjalën ‘Allah’ apo në ‘Allahum’ do të jetë i rëndë.




Rregulla e Raa-s së rëndë dhe të lehtë




Rregullat e Nûn-*sekineh* dhe të *tenwin*

Nûn-*sekineh* është një Nûn pa *hareke* apo me një shenjë të *sukunit* mbi të



Tenwin është një Nûn-*sekineh* e cila vjen në fund të emrave; ai shqiptohet, por nuk shkruhet si Nûn-*sekineh*.



> Vërejtje: *Tenwini* paraqitet vetëm në fund të emrave (përveç dy foljeve), ndërsa Nûn-*sekineh* mund të paraqitet kudo në një fjalë (në mes apo në fund).

Rregullat e Nûn-*sekineh* dhe të *tenwin* janë*:*

- Idhhar Halki
- Idgam
- Iklab
- Ikhfa Hakiki

Idhhar Halki

Idhhar do të thotë e qartë.

Shkronjat e *idhharit* janë:

خ غ ح ع هـ ء

Mënyra e shqiptimit: Nëse një Nûn-*sekineh* apo një *tenwin* pasohet nga cilado prej 6 shkronjave të fytit, Nûn-*sekineh* apo *tenwini* shqiptohet qartë, pa *gunneh*.

Shembuj të Nûn-*sekineh*:

لِمَنْ خَشِيَ	عَنْهُمْ	مِنْ أَهْلِ
مِنْ أَيِّ	أَنْعَمْتَ	يَنْهَىٰ

Shembuj të *tenwinit*:

سَلَٰمٌ هِيَ	عَبْدًا إِذَا	يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا
كَٰذِبَةٍ خَاطِئَةٍ	طَعَامٌ إِلَّا	يَوْمَئِذٍ خَٰشِعَةٌ

Shënim: Nëse *tenwini* pasohet nga *Hemzetul-Wesl*, lexuesi duhet ta shqiptojë Nûn-in në *tenwin* sikurse Nûn me *kesreh*.

Shembull:

يَوْمَئِذٍ ٱلْمُسْتَقَرُّ

Iklab

Iklab do të thotë ndryshim.

Shkronjat e iklabit:

"ب"

Mënyra e shqiptimit: Nëse Nûn-*sekineh* apo *tenwini* pasohet nga një Be, ai shndërrohet në një Mîm i cili shqiptohet me prekje më të lehtë mes buzëve, dhe lexuesi duhet të bëjë *gunneh* me 2 takte.

Shembuj të Nûn-*sekineh*:



Shembuj të tenwinit:



Idgam

Idgam do të thotë të përziesh apo të fusësh një gjë në një tjetër; kjo është përzierja apo hyrja e një shkronje *sekin* në shkronjën pasuese *muteherrik* në mënyrë që të bëhen një shkronjë e vetme *mushedded*.

Shkronjat e idgamit: Ka 6 shkronja të idgamit dhe ato mund të përmblidhen në shprehjen "يرملون".

> Shënim: Nûn-*sekineh* apo *tenwini* dhe shkronja idgam duhet të jenë në dy fjalë të ndryshme, përndryshe lexuesi nuk duhet të bëjë idgam. Një rast i këtillë është *idhhar mutlak*, që gjendet vetëm në katër fjalë në Kuran:
>
> صِنۡوَانٌ قِنۡوَانٌ بُنۡيَٰنٌ ٱلدُّنۡيَا

Llojet e idgamit

- Idgami me *gunneh*

  Shkronjat e Idgamit me *gunneh* janë:

  "و" "م" "ن" "ي" ose . "ينمو"

  Nëse Nûn-*sekineh* apo *tenwini* pasohet nga cilado nga këto katër shkronja, lexuesi duhet të bëjë idgam me *gunneh* për 2 takte.

  Mënyra e shqiptimit: Kapërce Nûn-*sekineh* apo *tenwinin* dhe shqipto *gunneh* me shkronjën vijuese për 2 takte:

  Shembuj të Nûn-*sekineh*:

مِن وَرَآئِهِم	مِّن مَّسَدٍ	فَمَن يَعْمَلْ	فَلَن نَّزِيدَكُمْ

Shembuj të *tenwinit*:

يَوْمَئِذٍ نَّاعِمَةٌ	قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ	جَزَآءً مِّن	بَرْدًا وَلَا

- Idgami pa *gunneh*

Shkronjat e Idgamit pa *gunneh* janë:

" ر " " ل "

Nëse Nûn-*sekineh* pasohet nga cilado këto dy shkronja, nuk bëhet *gunneh* gjatë idgamit.

Mënyra e shqiptimit: Kapërce Nûn-*sekineh* apo *tenwinin* dhe shqipto Lam-in apo Ra-n pa *gunneh*.

Shembuj të Nûn-*sekineh*:

لَئِن لَّمْ	عَن رَّبِّهِمْ

Shembuj të *tenwinit*:

لَرَءُوفٌ رَّحِيمٌ	ذِكْرٌ لِّلْعَالَمِينَ

Ikhfa Hakiki

Ikhfa do të thotë të fshehësh; kjo është shqiptimi i Nûn-*sekineh* apo *tenwinit* në një mënyrë që tingulli del mes idgamit dhe idhharit.


Shkronjat e ikhfa: Çdo shkronjë, përveç shkronjave të idhharit, të iklabit apo të idgamit.

Mënyra e shqiptimit: Nëse cilado shkronjë tjetër veç atyre të idharit, të iklabit apo të idgamit pasojnë Nûn-*sekineh* apo *tenwinin*, lexuesi duhet të fshehë Nûn-*sekineh* apo *tenwinin*. Lexuesi, po ashtu, duhet të bëjë *gunneh* me 2 takte.


Gunneh për ikhfa: ka *gunneh* të rëndë dhe *gunneh* të lehtë.

Gunneh e rëndë: Nëse Nûn-*sekineh* apo *tenwini* pasohet nga njëra prej shkronja të rënda (ص ض ط ق ظ), tingulli i *gunneh* duhet të jetë i rëndë.

Shembuj të *gunneh-s* së rëndë me Nûn-*sekineh*:



Shembuj të *gunneh*-s së rëndë me *tenwin*:




Gunneh e lehtë: Nëse Nûn-*sekineh* apo *tenwini* pasohet nga një shkronjë e lehtë, tingulli i *gunneh*-s duhet të jetë i lehtë.

Shembuj të *gunneh*-s së lehtë me Nûn-*sekineh*:



Shembuj të *gunneh*-s së lehtë me *tenwin*:




Tabela e rregullave për Nûn-*sekineh* dhe *tenwin*
Iklab
Ndrysho Nûn-in në një Mim të fshehtë + *gunneh*.
مِنۢ بَعۡدِ / يَوۡمَئِذِۭ بِجَهَنَّمَ
Shiko shkronjën e radhës.
Idhhar Halki
Shqipto Nûn-in e qartë pa *gunneh*.
Nëse shkronja e radhës është një nga shkronjat në
يرملون
Idgam
Nëse shkronja e radhës është cilado shkronjë tjetër
Ndrysho shqiptimin e Nûn-it apo të *tenwinit* në një Nûn të fshehtë me *gunneh* për 2 takte.
Përveç nëse *tenwini* pasohet nga Hemzetul-Wesl
Shqipto Nûn-in në *tenwin* si Nûn me *kesra*
Shkruhet si:
Shqiptohet si:
Nëse shkronja është Lam ose Ra
Idgam pa *gunneh*
Kapërce Nûn-in apo *tenwinin* dhe shqipto Lam-in apo Ra-n pa *ghunneh*
Nëse shkronja është një nga shkronjat në
ينمو
Idgam me *gunneh*
Kapërce Nûn-in apo *tenwinin* dhe shqipto me *ghunneh* (2 takte) shkronjën e radhës
Nëse shkronja është një nga shkronjat e rënda
(ظ ق ط ض ص)
Nëse shkronja është një nga shkronjat e lehta (pjesa e mbetur e shkronjave)
Gunneh e rëndë
Gunneh e lehtë
Raste të veçanta
Shenja *sekt*
Prania e shenjës *sekt* do ta bëjë Nûn-in të shqiptohet qartë, pa idgam
Idhhar mutlak
Nëse Nûn-*sekineh* pasohet nga shkronjat e idgamit në fjalën e njëjtë, shqipto Nûn-in të qartë

Si të shqiptosh secilin rregull

Idhhar Halki

Për Nûn-*sekineh*:

نْ → نْ

Për *tenwin*:

ـٌ → ـُ + نْ

ـً → ـَ + نْ

ـٍ → ـِ + نْ

Shqiptohet:		Shkruhet:
منُ أهل	←	مِنْ أَهْلِ
نارُنْ حامية	←	نَارٌ حَامِيَةٌ
عبدَنْ اذا	←	عَبْدًا إِذَا
كـــاذبتِنْ خاطئة	←	كَـٰذِبَةٍ خَاطِئَةٍ

Idgam me *gunneh*:

Për Nûn-*sekineh*

1. Kapërce Nûn-in
2. Vendos një *sheddeh* imagjinare në shkronjën e radhës + tingulli hundor në shkronjën e radhës (2 takte).

Për *tenwin*:

1. Ndrysho

ـٌ → ـُ

ـً → ـَ

ـٍ → ـِ

2. Vendos (*sheddeh*) mbi shkronjën e radhës + tingulli hundor në shkronjën e radhës (2 takte).

Shqiptohet:		Shkruhet:
فميّعمل	←	فَمَن يَعْمَلْ
منّعمة	←	مِن نِّعْمَةٍ
مـــمّسد	←	مِّن مَّسَدٍ
موّرائهم	←	مِن وَرَآئِهِم
وجوهُ يّومئذ	←	وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ
نارُ مّؤصدة	←	نَارٌ مُّؤْصَدَةٌ
خيرُ وّأبقى	←	خَيْرٌ وَأَبْقَىٰ
خيرَ يّره	←	خَيْرًا يَرَهُ
ووالد وّما	←	وَوَالِدٍ وَمَا

Idgam pa *gunneh*

	Shqiptohet:		Shkruhet:
Për Nûn-*sekineh*:			
Kapërce Nûn-in	أ لَّن	←	أَن لَّن
	أ رَّءاه	←	أَن رَّءَاهُ
Për *tenwin*:			
Ndrysho			
ٌ → ُ	خيرُ لَّك	←	خَيْرٌ لَّكَ
ً → َ	عيشةِ رَّاضية	←	عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ
ٍ → ِ	فيومئذِ لَّا	←	فَيَوْمَئِذٍ لَّا

Ikhfa Hakiki

Për Nûn-*sekin*:

Ndrysho نْ → ن i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

	Shqiptohet si:		Shkruhet si:
Gunneh e lehtë	مـنـشر	←	مِن شَرِّ
	يُـنـفخ	←	يُنفَخُ
Gunneh e rëndë	فليَـنـظر	←	فَلْيَنظُرِ
	عَـنـطبق	←	عَن طَبَقٍ

Për *tenwin*:

Ndrysho ٌ → ُ + ن i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

Ndrysho ً → َ + ن i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

Ndrysho ٍ → ِ + ن i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

	Shqiptohet si:		Shkruhet si:
Gunneh e lehtë	إطعامُـنـفى	←	إِطْعَٰمٌ فِي
	يتيمَـنـذا	←	يَتِيمًا ذَا
Gunneh e rëndë	صفَّـنـصفا	←	صَفًّا صَفًّا

Iklab

Për Nûn-*sekineh*:

Ndrysho → م i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

Shqiptohet:		Shkruhet:
مــمــبين	←	مِنۢ بَيۡنِ
فأَمــبتنا	←	فَأَنۢبَتۡنَا

Për *tenwin*:

Ndrysho	ٌ	→	ُ	+	م i fshehtë me tingull hundor (2 takte)
Ndrysho	ً	→	َ	+	م i fshehtë me tingull hundor (2 takte)
Ndrysho	ٍ	→	ِ	+	م i fshehtë me tingull hundor (2 takte)

Shqiptohet:		Shkruhet:
كرامــمــبررة	←	كِرَامِۭ بَرَرَةٍ
محيطُــمــبل	←	مُّحِيطٌۢ بَلۡ

Rregullat e Mim-*sekineh*

Mim-*sekineh* është një Mim pa *hareke* apo një Mim pa shenjën e sukunit ()

Rregullat e Mim-*sekineh*:

1. Ikhfa Shefewi
2. Idgam Mutemethilejn Sagir
3. Idhhar Shefewi

Ikhfa Shefewi

Ikhfa do të thotë të fshehësh, pra kjo do të thotë të fshehësh Mim-in duke bërë një prekje më të lehtë mes buzëve.

Shkronjat e Ikhfa Shefewi janë:

“ب”

Mënyra e shqiptimit: Nëse Mim-*sekineh* pasohet nga Be, Mim-i shqiptohet në mënyrën që dy buzët preken më lehtë; po ashtu bëhet *gunneh* për 2 takte.

Shembuj:

رَبُّهُم بِذَنۢبِهِمْ	يَعْلَم بِأَنَّ	فَبَشِّرْهُم بِعَذَابٍ

Idgam Mutemethilejn Sagir

Idgam do të thotë të përziesh apo të vendosësh një gjë në një tjetër; kjo është përzierja apo futja e një shkronje *sekin* (Mim) në një shkronjë vijuese *muteherrik* (Mim).

Shkronja e Idgam Mutemethilejn Sagir është Mim.

Mënyra e shqiptimit: Nëse Mim-*sekineh* pasohet nga një Mim, Mim-i i dytë shqiptohet me *gunneh* 2 taktesh.

Shembuj:

أَنَّهُم مَّبْعُوثُونَ	وَرَآئِهِم مُّحِيطٌ	وَءَامَنَهُم مِّنْ

Idhhar Shefewi

Idhhar Shefewi do të thotë e qartë apo Mim i qartë.


Shkronjat e Idhhar Shefewi janë të gjitha shkronjat, përveç Be dhe Mim.

Mënyra e shqiptimit: Nëse Mim-*sekineh* pasohet nga cilado shkronjë tjetër veç Be dhe Mim, ajo duhet të shqiptohet qartë duke bërë kontakt të plotë mes dy buzëve.

Shembuj:

أَلَمْ تَجْعَلْ	هُمْ يُرَآءُونَ	هُمْ عَن	صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

Rregullat e Mim-*sekineh*



El-Med

El-Med do të thotë zgjatje. Kjo mund të definohet edhe si zgjatje e shkronjave Med në kushte të caktuara.

Mënyra e shqiptimi: el-Med mund të zgjatet nga 2 deri në 6 takte, varësisht nga lloji i saj.

Shkronjat që kanë Med

1. Je-*sekineh* e paraprirë nga një shkronjë me *fet'ha*. Shembull:

   قُرَيْش

2. Waw-*sekineh* i paraprirë nga një shkronjë me *fet'ha*. Shembull:

   خَوْف

1. Elif-*sekineh* i paraprirë nga një *fet'ha*. Shembull:

   تِجَارَة

2. Waw-*sekineh* i paraprirë nga një *dammeh*. Shembull:

   جُوع

3. Je-*sekineh* e paraprirë nga një *kesre*. Shembull:

   دِينُكُمْ

Llojet e Med

- Med Tabi’i
- Med Bedel
- Med Iwed
- Med A’rid li-Sukun
- Med Lin
- Med Waxhib Mutasil
- Med Xha’iz Munfesil
- Med Lazim

Med Tabi’i

Med Tabi’i nënkupton Med-in e natyrshëm. Med-i i natyrshëm zbatohet te shkronjat e Med-it (Elif, Waw dhe Je), të cilat nuk pasohen nga një *hemzeh* apo një shkronjë *sekin*.

Medi natyral zgjatet 2 takte. Shembull:

بِحِجَارَةٍ	تَرْمِيهِم	مَّأْكُولٍ

Med Bedel

Med Bedel mund të definohet si: çdo *hemze* që i paraprinë një shkronje Med. Med Bedel, nëse nuk pasohet nga një shkronjë *sekin* apo një *hemzeh*, zgjatet vetëm 2 takte. Shembull:

ٱلْأَيَةَ	رَءَاهُ	بِـَٔايَـٰتِنَا

Med Iwed

Iwed do thotë kompensim. Med Iwed është zëvendësim i një *tenwini fet’ha* që gjendet në fund të një fjale me një Elif Med, kur ndalesh tek ajo.[3]

Med Iwed zgjatet 2 takte. Shembull:

[3] Përveç Te Merbuta. Lexuesi duhet të ndalet te Te Merbuta dhe ta shqiptojë atë si He me *sukun*.

صَفًّا	أَمْرًا	سَبْحًا	مَآءً	تُرَابًا

Med A’rid li-Sukun

Med A’rid li-Sukun do të thotë Med i përkohshëm për ndalje. Nëse një Med Tabi’i pasohet nga një shkronjë në fund të fjalës e cila është bërë *sekin* përkohësisht për shkak se lexuesi duhet të ndalet aty, lexuesi duhet ta zgjasë Med Tab’i-n për ta bërë Med li-Sukun. Med A’rid li-Sukun mund të zgjatet 2, 4 apo 6 takte. Por, për hir të thjeshtësisë, do ta zgjasim 4 takte.

> Shënim: Ky Med ekziston vetëm atëherë kur lexuesi ndalet në atë fjalë. Nëse lexuesi nuk ndalet në të, ajo duhet të konsiderohet si një Med Tabi’i (2 takte).

Shembuj:

يَتَسَآءَلُونَ	ٱلرَّحْمَـٰنُ	ٱلْعَظِيمِ	أَخِيهِ	سِجِّيلٍ

Med Lin

Lin do të thotë lehtë.

Shkronjat Lin janë: Waw apo Je-*sekineh* e paraprirë nga një shkronjë me *fet’ha*.

Kur duhet bërë këtë Med?

Nëse një nga shkronjat Lin pasohet nga një shkronjë në fund të një fjale e cila bëhet *sekin* për shkak të ndaljes[4], lexuesi duhet të zgjasë shkronjën Lin. Lexuesi mund të zgjedhë ta zgjasë atë 2, 4, apo 6 takte. Shembull:


وَٱلصَّيْفِ	ٱلْبَيْتِ	خَوْفٍ

[4] Nëse lexuesi nuk ndalet, nuk zbatohet asnjë Med.

Med Waxhib Mutasil

Waxhib do të thotë e obligueshme, ndërsa *Mutasil* do të thotë e bashkuar.

Nëse një shkronjë Med (Elif, Waw ose Je) pasohet nga një *hemzeh* e cila gjendet në të njëjtën fjalë, lexuesi duhet ta zgjasë atë 4-5 takte. Shembull:




ٱلسَّمَآءِ	ٱلسَّمَآءُ	شَآءَ	أُوْلَـٰٓئِكَ	وَجِاْىٓءَ

Med Xha’iz Munfesil

Xha’iz do të thotë e lejueshme, ndërsa Munfesil do të thotë e ndarë.

Nëse një shkronjë Med (Elif, Waw apo Je) që gjendet në fund të një fjale pasohet nga një *hemzeh* e cila gjendet në fillim të fjalës së radhës, lexuesi duhet ta zgjasë shkronjën Med 4-5 takte, që është Med Xha’iz Munfesil[5].

Med Lazim



Med Lazim Kelimi Muthekkal

Nëse një shkronjë Med pasohet nga një shkronjë *mushedded*, lexuesit i kërkohet të zgjasë shkronjën Med; ajo duhet të zgjatet 6 takte. Shembull:

---

[5] Nëse lexuesi ndalet mbi një shkronjë e cila përfundon me shenjën Med - si “*el-ledhi”* -, Med-i do të konsiderohet si Med Tabi’i (2 takte).

ضَآلًّا	ٱلطَّآمَّةُ	ٱلصَّآخَّةُ

Med Lazim Kelimi Mukhaffef


Nëse një shkronjë Med pasohet nga një shkronjë *sekin* e cila gjendet në të njëjtën fjalë, lexuesi duhet ta zgjasë shkronjën Med; ajo duhet të zgjatet jo më pak se 6 takte. Shembuj:

ءَآلْـَٔنَ

Med Lazim Harfi Muthekkal


Nëse një shkronjë Med pasohet nga një shkronjë *mushedded*, lexuesi duhet ta zgjasë shkronjën Med; ky Med duhet të zgjatet 6 takte. Shembuj:

Shqiptohet:	Shkruhet:
(10) كَـافْ هَـا يَـا عَـيْـن صَـادْ 6 beats	كٓهيعٓصٓ
أَلِفْ لَـامْ مِّـيـمْ صَـادْ 6 beats	الٓمٓصٓ
أَلِفْ لَـامْ مِّـيـمْ رَا 6 beats	الٓر
أَلِفْ لَـامْ مِّـيـمْ 6 beats	الٓمٓ



Med-i bëhet i nevojshëm me praninë e:
Nëse është Elif Med
Shkronjat Med
Elif, Waw dhe Je
Shkronjat Lin (Je ose Waw-*sekineh* e paraprirë nga *fet'ha*)
Kjo është rezultat i ndaljes në *tenwin fet'ha*, përveç *tenwinit* në Te Merbuta.
Pasuar nga cilado shkronjë, përveç *hemzes* apo një shkronje *sekin*
Paraprirë nga *hemzeh*
Pasuar nga
Shkronja *mushedded*
Shkronja *sekin*
Med Lazim Kelemi Muthekkal
Med Lazim Harfi Muthekkal
Med Lazim Harfi Mukhaffef
Med Lazim Kelemi Mukhaffef
6 takte
Pasuar nga *hemze*
Në fjalën e njëjtë
Në fjalën e radhës
Med Waxhib Mutasil
Med Xhaiz Munfesil
4 - 5 takte
Pasuar nga një shkronjë *sekin* për shkak të ndalesës
Med A'rid Li Sukun
Pasuar nga një shkronjë *sekin* për shkak të ndaljes
Med Lin
2, 4 apo 6 takte
Med Iwad
Med Tabi'i
Med Bedel
2 takte

Ndalja te fundi i fjalëve



Cilësitë e shkronjave

Cilësitë e përhershme pa të kundërtat e tyre

1. Kalkaleh
2. Es-Safir
3. El-Lin
4. El-Inhiraf
5. Et-Tekrir
6. Et-Tefeshshi
7. Istitaleh

Cilësitë e përhershme me të kundërtat e tyre

El-Xhehr	⟺	**El-Hems**
Esh-Shiddeh	⟺ (**Et-Tewessut**)	**Er-Rakhaweh**
Istia'le	⟺	**Istifel**
Infiteh	⟺	**Itbek**
Idhlek	⟺	**Ismet**

E para: Cilësitë e përhershme me të kundërtat

Llojet & definicionet

Hems

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon fshehje.

Kuptimi teknik i fjalës tregon vazhdimësi të frymës gjatë shqiptimit të shkronjës, për shkak të dobësisë në nismën e saj, gjë që shkakton presion të dobët në vend-daljen e saj.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

فحثه شخص سكت

Xhehr

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon dukje.

Kuptimi teknik i fjalës tregon ndërprerje të frymës gjatë shqiptimit të shkronjës, për shkak të fortësisë në nismën e saj, gjë që shkakton presion më të madh në vend-daljen e saj.

Pjesa e mbetur e shkronjave e kanë këtë cilësi.

Rakhaweh

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon butësi.

Kuptimi teknik i fjalës tregon për një vazhdimësi të tingullit gjatë shqiptimit të shkronjës, gjë që shkakton presion të dobët në vend-daljen e saj.

Këtë cilësi e kanë të gjitha shkronjat, përveç shkronjave të Shiddes dhe të Tewessut.

Et-Tewessut

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon mesatare.

Kuptimi teknik i fjalës tregon për një pozitë mes forcës dhe butësisë ashtu që tingulli vazhdohet pjesërisht dhe ndërpritet pjesërisht.

Kjo nuk është cilësi në vetvete, por hyn mes Shiddes dhe Rakhawes.

Kjo cilësi gjendet në shkronjat në vijim:

لن عمر

Shiddeh

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon forcë.

Kuptimi teknik tregon për ndërprerje të tingullit gjatë shqiptimit të shkronjës, gjë që shkakton presion më të madh në vend-daljen e saj.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

أجدك تقطب

Istia'le

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon ngritje.

Kuptimi teknik tregon për ngritjen e pjesës së fundme të gjuhës drejt qiellzës së gojës gjatë shqiptimit të shkronjës.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

خص ضغط قظ

Itbek

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon ngjitje.

Kuptimi teknik tregon për ngjitjen e gjuhës në qiellzën e gojës gjatë shqiptimit të një shkronje.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim (këto shkronja kanë Istia'le po ashtu):

ص ض ط ظ

Idhlek

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon rrjedhshmëri, qartësi në të folur.

Kuptimi teknik tregon për artikulim të shkronjave nga anët e gjuhës apo të buzëve me lehtësinë më të madhe, sikur ato të rrëshqitnin.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

فر من لب

Istifel

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon lëshim.

Kuptimi teknik tregon për uljen e pjesës së fundme të gjuhës nga qiellza e gojës gjatë shqiptimit të shkronjës.

Këtë cilësi të istifel e kanë të gjitha shkronjat, përveç shkronjave të istia'le.

Infiteh

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon ndarje.

Kuptimi teknik tregon për mbajtjen e gjuhës të ndarë nga qiellza e gojës gjatë shqiptimit të një shkronje.

Përveç shkronjave itbek, të gjitha shkronjat e tjera kanë cilësinë infiteh.

Ismet

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon hapësirë.

Kuptimi teknik tregon për artikulim të shkronjave me qëndru-eshmërinë dhe forcën më të madhe të mundshme nga vend-dalja e tyre, pa çka shkronja nuk do të artikulohej.

Të gjitha shkronjat e tjera kanë këtë cilësi.

E dyta: Cilësitë e përhershme pa të kundërtat

Llojet & definicionet

1. **Kalkaleh**

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon jehonë.

Kuptimi teknik tregon për një cilësi të përhershme që krijon një tingull jehues apo një hov të lehtë në vend-dalje.

Kjo cilësi gjendet në 5 shkronjat në vijim:

ق ط ب ج د (قطب جد)

Ka tri nivele të Kalkales sa i përket forcës së shqiptimit të saj:

- Më i forti: kur ndalesh (bën *wekf*) në një shkronjë *mushedded* të Kalkales.
- I forti: kur ndalesh në një shkronjë *sekin* të Kalkales.
- I dobëti: kur shkronja *sekin* e Kalkales gjendet në mes të fjalës.

وَٱلۡحَجِّ	أَحَدٌ	صَدۡرَكَ
ٱلۡحَقُّ	ٱلصَّمَدُ	أَطۡعَمَهُم
وَتَبَّ	حَسَدَ	ٱلۡأَبۡتَرُ

2. **Es-Safir**

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon fishkëllimë.

Kuptimi teknik tregon tingullin si të një fishkëllime natyrale, që del gjatë shqiptimit të shkronjave.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

س ص ز

3. El-Lin

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon butësi.

Kuptimi teknik tregon për artikulimin e shkronjës nga vend-dalja e saj me një lehtësi dhe butësi të natyrshme e cila gjendet në shkronjë.

Këtë cilësi e kanë shkronjat në vijim:

- Waw-*sekineh* me *fet'ha* në shkronjën para saj.
- Je-*sekineh* me *fet'ha* mbi shkronjën para saj.

4. El-Inhiraf

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon devijim.

Kuptimi teknik tregon për devijimin e lehtë të gjuhës drejt vend-daljes së Ra-s gjatë shqiptimit të Lam-it, dhe drejt Lam-it gjatë shqiptimit të Ra-s.

Kjo cilësi gjendet vetëm në dy shkronjat në vijim:

ل ر

5. Et-Tekrir

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon përsëritje.

Kuptimi teknik tregon për dridhmën e gjuhës gjatë shqiptimit të shkronjës, çka bën që shkronja të shqiptohet më shumë se një herë.

Këtë cilësi e ka vetëm shkronja:

ر

> Shënim: Ndryshe nga cilësitë e tjera, ne duhet të përmbahem nga kjo cilësi gjatë shqiptimit të kësaj shkronje.

6. Et-Tefeshi

Kuptimi i drejtpërdrejtë tregon shpërndarje.

Kuptimi teknik tregon për shpërndarje të tingullit të shkronjës në gojë gjatë shqiptimit të saj.

Këtë cilësi e ka vetëm shkronja:

ش

7. **Istitaleh**

Kuptim i drejtpërdrejtë tregon zgjatje.

Kuptimi teknik tregon për zgjatje të tingullit përgjatë daljes së tij nga fillimi deri në fund (1.5 deri në 1.75 takte).

Kjo cilësi gjendet vetëm në pozitën e *sukunit* apo *sheddes* për shkronjën:

ض